



ADVOKASIA DHE ZGJEDHJET VENDORE



EKSPERIENCA E PARTNERËVE SHQIPËRI 2011



Partnerët Shqipëri
Qendra për Ndryshim
dhe Manaxhim Konflikti

B | T | D The Balkan Trust for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

ADVOKASIA DHE ZGJEDHJET VENDORE, EKSPERIENCA E PARTNERËVE SHQIPËRI 2011

Punoi: Klotilda Tavani Kosta
Kostandina Këruti

Dhjetor 2011



Partnerët Shqipëri
Qendra për Ndryshim dhe
Menaxhim Konfliktit

B | T | D The Balkan Trust for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

Ky botim u përgatit nga Partnerët Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti me mbështetjen e Balkan Trust for Democracy në kuadër të projektit “Fuqizimi i praktikave demokratike të pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në proceset zgjedhore”.

Opinionet e shprehura në botim nuk reflektojnë domosdoshmërisht këndvështrimin e Balkan Trust for Democracy, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara, apo partnerëve të tij.

Të drejtat e Autorit © 2011

Partnerët Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti

Rruga “Muhamet Gjollesha” P.16/1, Hyrja.1, Ap.9, Tiranë

Kutia Postare 2418/1

Tel: +355 4 2254881

Faks: +355 4 2254883

E-mail: partners@partnersalbania.org

Website: www.partnersalbania.org

ISBN 978-9928-4025-5-4

Graphic Design: Creative Plus

PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJE.....	1
2. KONTEKSTI.....	2
3. NISMA E PARTNERËVE SHQIPËRI.....	3
3.1. Faza 1: Ngritja e koalicioneve lokale.....	3
3.2. Faza 2: Ngritja e kapaciteteve.....	4
3.3. Faza 3: Hartimi i një fushate advokuese.....	4
3.4. Faza 4: Zbatimi i fushatës advokuese.....	5
3.5. Faza 5: Monitorimi i premtimeve zgjedhore.....	6
4. REZULTATET KRYESORE TË FUSHATËS ADVOKUESE....	7
5. MËSIMET E NXJERRA.....	8
6. ANEKSE.....	9
6.1. Fushata Lokale Korçë.....	9
6.2. Fushata Lokale Pogradec.....	11
6.3. Fushata Lokale Berat	13
6.4. Fushata Lokale Elbasan.....	15

1. PËRMBLEDHJE

Në 8 maj 2011, në Shqipëri u zhvilluan zgjedhjet vendore për kryetarët dhe këshillat e Njësive të Qeverisjes Vendore. Këto zgjedhje ishin të parat të mbajtura sipas Kodit të ri Zgjedhor të miratuar në vitin 2008.

Ndërsa demokracia në Shqipëri është ende në formim e sipër, nevoja për forcimin e institucioneve dhe praktikave demokratike mbetet e rëndësishme. Për këtë arsye, Partnerët Shqipëri zbatuan për të dytën herë një përfaqje advokuese për të mbështetur procesin demokratik përmes prezantimit dhe zbatimit të praktikave demokratike të pjesëmarrjes qytetare në proceset zgjedhore.

Kjo nismë ndihmoi në rritjen e pjesëmarrjes qytetare në procesin zgjedhor; përmirësoi nivelin e komunikimit ndërmjet qytetarëve dhe liderëve të ardhshëm vendorë; nxiti dialogun dhe ndikimin e qytetarëve dhe shoqërisë civile në axhendën e kandidatëve për kryetarë bashkie dhe rriti përgjegjshmërinë e liderëve të zgjedhur. Kjo nismë orientoi qytetarët sesi të përdorin zgjedhjet për të arritur qëllimet e përbashkëta duke bashkëpunuar me njëri – tjetrin.

Partnerët Shqipëri asistoi organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e tjera të interesit si: intelektualët, studentët, gratë etj në formimin e koalicioneve lokale dhe në identifikimin e çështjeve prioritare. PSh gjithashtu punoi në drejtim të rritjes së kapaciteteve të tyre në hartimin dhe zbatimin e fushatave të advokatisë rreth çështjeve prioritare të identifikuara. Fushatat e advokatisë kulmuan me marrjen e premtimeve për realizimin e çështjeve nga të gjithë kandidatët për kryetarë bashkie në Berat, Elbasan, Pogradec e Korçë. Monitorimi i premtimeve dhe takime diskutimi mes koalicioneve dhe kryetarëve të zgjedhur të bashkive respektive pasuan zgjedhjet vendore, për të identifikuar mënyrat dhe mundësitë e realizimit të këtyre premtimeve, si dhe për të mobilizuar të gjithë aktorët në nivel lokal.

Ky publikim thekson praktikën e pjesëmarrjes qytetare në fushatën zgjedhore për Pushtetin Vendor që rezultuan gjatë zbatimit të këtij projekti. Ai synon të rrisë besimin e qytetarëve për ndikimin dhe kontributin e tyre drejt një procesi zgjedhor demokratik dhe një qeverisjeje me pjesëmarrje.

2. KONTEKSTI

Zgjedhjet për qeverisjen vendore në Shqipëri të mbajtura në 8 maj 2011 rezultuan me emërimin e kryetarëve dhe këshilltarëve të 384 NJQV-ve (Bashki, Komuna dhe Minibashki në Tiranë). Sipas të dhënave të KQZ-së, 51% e 3.1 milion votuesve morën pjesë në votime në mbarë Shqipërinë. Kjo përqindje është pak më e lartë se ajo e zgjedhjeve vendore të vitit 2007, kur vetëm 47% e votuesve dhanë votën e tyre. Megjithë rritjen, kjo përqindje që është një tregues i pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset demokratike, mbetet në nivele të ulta, dhe reflekton edhe një herë nivelin e ulët të besimit të qytetarëve te partitë politike.

Zgjedhjet e 8 majit u mbajtën në një klimë politike të tensionuar dhe të polarizuar, duke ndjekur zgjedhjet parlamentare të 28 qershorit 2009, nga të cilat, me shumicë vote, rezultoi fituese Partia Demokratike, e cila në koalicion me Lëvizjen Socialiste për Integrim formoi qeverinë e re të Shqipërisë. Rezultatet e zgjedhjeve parlamentare të 28 qershorit, nuk u pranuan nga Partia Socialiste (PS), e cila bojkotoi parlamentin deri në Mars të 2011. Ky bojkot u shoqërua edhe me protesta e manifestime të ndryshme kundër qeverisë, të cilat kulmuan me protestën e 21 janarit 2011, e cila rezultoi me katër protestues të vdekur e të tjerë protestues e përfaqësues të forcave policore të lënduar si pasojë e konfrontimeve të dhunshme mes tyre.

Kjo situatë e tensionuar u reflektua edhe gjatë fushatës zgjedhore për pushtetin vendor të 2011, ku nuk munguan incidentet si dhe retorika e ashpër midis kandidatëve dhe forcave politike që ata përfaqësonin. Incidentet dhe dhuna ishin të pranishme edhe gjatë ditës së votimit në disa prefektura, ndërmjet simpatizantëve madje edhe ndërmjet kandidatëve në raste sporadike. Si asnjëherë më parë, kandidatët në këto zgjedhje pothuajse në të gjitha NJQV-të refuzuan të debatojnë publikisht ballëpërballë njëri-tjetrit në prani të qytetarëve mbi problemet e përditshme dhe alternativat konkrete për zgjidhjen e tyre.

Kjo situatë citohet edhe në Raportin Konkluzione Paraprake të Zgjedhjeve Vendore 2011, të Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë (koalicion i përbërë nga organizata jo-fitimprurëse dhe jo-politike): “Janë vënë re fare pak përballje mediatike kandidatësh. Kryesisht fushata po zhvillohet nga kandidatët në garë nëpërmjet takimeve “derë më derë” dhe takime direkte me qytetarët. Kandidatët, në disa raste, kanë përdorur tone fyese e agresive kundër njëri-tjetrit duke kulmuar, në raste sporadike, edhe në forma të tjera konflikti”

Megjithë ndryshimet pozitive që shënuan këto zgjedhje në lidhje me listat e votuesve dhe mbulimin e gjerë mediatik, përsa i përket pjesëmarrjes qytetare, si një tipar themelor i demokracisë, ato treguan që ka ende vështirësi në ndërtimin e partneriteteve të qëndrueshme, në ndarjen e barabartë të përgjegjësive mes

aktorëve, në ngritjen e strukturave advokuese dhe ndonjëherë në përhapjen e informacionit. Shpesh këto vështirësi shkaktohen nga mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme të grupeve lokale për të përkthyer çështje të ndryshme të interesit në qëllime të përbashkëta dhe për t'i tërhequr ato në vëmendjen politike. Mungesa e komunikimit midis liderëve të zgjedhur dhe komuniteteve që ata përfaqësojnë është një tjetër faktor që ndikon negativisht në pjesëmarrjen aktive të qytetarëve.

3. NISMA E PARTNERËVE SHQIPËRI

Partnerët Shqiperi beson se fushata zgjedhore është një mundësi ideale për të tërhequr vëmendjen e kandidatëve për kryetarë bashkie drejt çështjeve dhe problemeve prioritare në komunitetet e tyre. Gjithashtu, Partnerët Shqipëri beson në fuqinë e OJF-ve dhe grupeve të tjera të interesit për të ndikuar axhendat e liderëve lokalë mbi këto çështje.

Nisur nga ky qëndrim, Partnerët Shqipëri filloi në shtator të 2010 zbatimin e projektit ***“Fuqizimi i praktikave demokratike të pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në proceset zgjedhore”*** në qytetet Korçë, Pogradec, Berat dhe Elbasan. Projekti u mbështet nga Balkan Trust for Democracy, një projekt i Fondit Gjerman Marshall dhe Ambasada Amerikane në Shqipëri.

Kjo nismë synoi të forcojë demokracinë në vend përmes pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në proceset zgjedhore. Nisma e PSh konsistoi në ngritjen e grupeve aktive lokale në qytetet e targetuara, forcimin e kapaciteteve, lehtësimin, mbështetjen dhe këshillimin e tyre për hartimin dhe zbatimin e fushatave të advokatisë si dhe monitorimin e premtimeve të bëra nga kandidatët për kryetar bashkie gjatë fushatës zgjedhore, në mbrojtje të interesave të qytetarëve.

Kjo iniciativë vijoi eksperiencën e suksesshme të Zgjedhjeve Vendore të vitit 2007, në të cilën Partnerët Shqipëri, në kuadër të programit Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri, mbështeti grupe të shoqërisë civile në shtatë qytete të Shqipërisë për organizimin e fushatave advokuese nën moton “Unë mbështes Qeverisjen e Mirë”.

Iniciativa “Unë mbështes Qeverisjen e Mirë”, e realizuar në kuadër të zgjedhjeve vendore 2011, konsistoi në këto komponentë kryesore:

3.1. Faza 1: Ngritja e koalicioneve lokale

Nisma nisi me identifikimin e grupeve të shoqërisë civile në qytetet e përzgjedhura, të gatshëm për të kontribuar në përmirësimin e demokracisë në nivel lokal. Në secilin qytet u organizuan tryeza të rumbullakëta gjithëpërfshirëse, të cilat shërbyen për të prezantuar nismën tek aktorët lokalë dhe për t'i ftuar ata të

merrnin pjesë aktivisht në këtë nismë si pjesë e një koalicioni lokal i cili do të hartonte dhe zbatonte fushatën e advokasisë rreth një çështjeje me interes publik të zgjedhur prej tyre.

Si rezultat, në secilin qytet u formuan koalicione me 15- 20 anëtarë, kryesisht me përfaqësues të OJF-ve dhe grupeve të tjera si intelektualë, studentë, gra, etj. Çdo koalicion u pagëzua nga anëtarët e vet me emrin përkatës, si më poshtë:

- Korçë – Koalicioni për Pjesëmarrjen Rinore në Proceset Vendimmarrëse
- Pogradec – Koalicioni për Mbështetjen e Familjeve në Nevojë
- Berat – Koalicioni për Zhvillimin e Turizmit
- Elbasan – Koalicioni për të Ndhmuar Fëmijët të Jetojnë si Fëmijë

3.2. Faza 2: Ngritja e kapaciteteve

Anëtarët e koalicioneve lokale vinin nga eksperiencia të ndryshme dhe shumë prej tyre nuk ishin përfshirë në fushata advokuese dhe nisma të ngjashme më parë. Si rrjedhojë, hapi tjetër i procesit ishte ngritja e kapaciteteve të tyre në çështjet e “Advokasisë Kooperuese”.

PSh ndërtoi programe trainimi me qëllim rritjen e njohurive dhe aftësive të anëtarëve të koalicionit në dy drejtime: **Advokasi dhe Lobim** për të ndihmuar ata në identifikimin e çështjeve prioritare, hartimin dhe zbatimin e fushatave të advokasisë, si dhe **Teknikat Monitoruese të Qeverisjes Vendore**, për të aftësuar ata në monitorimin e premtimeve të liderëve të zgjedhur në realizimin e çështjeve.

Çështjet që u trajtuan gjatë programeve të trajnimit ishin të lidhura me fushatat e advokasisë, marrëdhëniet me median, zhvillimin e mesazhit, formimin e koalicioneve, mobilizimin e vazhdueshëm, teknika lobimi, teknika monitoruese të qeverisjes vendore, etj.

3.3. Faza 3: Hartimi i një fushate advokuese

Nën asistencën e PSh dhe bazuar në njohuritë, aftësitë dhe teknikat e përvetësuara nga programet e trajnimit, anëtarët e koalicionit punuan mbi planifikimin strategjik të fushatave advokuese që do të zhvilloheshin gjatë fushatës zgjedhore, për të ndikuar axhendën e kandidatëve për kryetar bashkie në qytetet respektive.

Fillimisht, koalicionet punuan për identifikimin dhe përzgjedhjen e problemeve kryesore dhe nevojave prioritare të qytetarëve. Më pas, anëtarët e koalicioneve zhvilluan një plan strategjik të detajuar me aktivitete konkrete për të tërhequr vëmendjen e qytetarëve dhe vendimmarrësve mbi çështjen e përzgjedhur, si

dhe për të identifikuar aleatë dhe mbështetës të fushatës. Pas diskutimeve mbi nevojat e parashtruara nga të gjithë anëtarët, Koalicionet zgjedhën të punojnë mbi çështjet e mëposhtme:

- Korçë** – Zhvillimi i një strategjie lokale të rinisë
- Pogradec** – Krijimi i mundësive të punësimit për gratë kryefamiljare në nevojë
- Berat** – Zhvillimi i Turizmit përmes forcimit të rolit dhe kompetencave të Zyrës së Turizmit në bashki
- Elbasan** – Krijimi i parqeve publike për fëmijë

3.4. Faza 4: Zbatimi i fushatës advokuese

Kjo fazë ishte ngushtësisht e lidhur me aktivitete specifike të hartuara nga koalicionet në çdo qytet, në përputhje me çështjen e zgjedhur. Pavarësisht aktiviteteve specifike sipas çështjes në qytetet respektive, elementët kryesorë të secilës fushatë advokuese ishin:

Aktivitete promovuese: Koalicionet hartuan mesazhin dhe sloganin për fushatat advokuese. Për të shpërndarë mesazhin e fushatës, informuar qytetarët dhe për të mobilizuar mbështetësit e nismës, u prodhuan dhe u shpërndanë postera dhe u vendosën banderola në pjesët kryesore të çdo qyteti. Fushatat advokuese u udhëhoqën nga sloganet e mëposhtme:

- Korçë** – Të rinjtë në vendimmarrje, më shumë mundësi, më shumë zgjidhje!
- Pogradec** – Mbështet një nënë kryefamiljare, ndihmo një familje!
- Berat** – Turizmi, e ardhmja që garanton mirëqënien!
- Elbasan** – Më shumë hapësira për fëmijët tanë!

Mobilizim i mbështetësve: Gjatë periudhës parazgjedhore, anëtarët e koalicionit organizuan takime, tryeza të rrumbullakëta dhe diskutime me aktorë të ndryshëm në qytet si grupet e biznesit, media, etj., me qëllim identifikimin dhe rritjen e numrit të mbështetësve. Koalicionet hartuan “Letra Pozicionimi” nëpërmjet të cilave u prezantuan kandidatëve dhe forcave politike që i mbështesnin, çështjen advokuese dhe alternativat e propozuara për zgjidhjen apo përmirësimin e tyre. Në takimet e zhvilluara me kandidatët, anëtarët e koalicionit i ftuan ata të marrin pjesë në forume të hapura me qytetarët, për të paraqitur platformat e tyre dhe për të diskutuar çështje me interes për komunitetin.

Forumet e hapura me kandidatët për kryetar bashkie: Sikundër ishte parashikuar që në fillim të nismës, bazuar edhe në eksperiencat e kaluara, ky ishte komponenti më sfidues i fushatës advokuese. Forumet e hapura u paraprinë nga përpjekje intensive lobuese dhe negocime me partitë politike dhe të gjithë kandidatët për kryetar bashkie në Berat, Elbasan, Korçë dhe Pogradec. Në forumin e hapur të gjithë kandidatët do të kishin mundësi të prezantonin programin e tyre

drejtues dhe t'u përgjigjeshin pyetjeve të qytetarëve. Qytetarët do të mund të informoheshin rreth strategjive konkrete për të përmirësuar situatën sa i përket çështjeve prioritare të përzgjedhura. Në fund të forumeve ishte parashikur që kandidatët të firmosnin premtimet e tyre në prani të publikut dhe medias së pranishme. Forumet e hapura do të transmetoheshin nga stacionet televizive lokale dhe/ose kombëtare.

Ashtu sikundër ndodhi edhe në qytetet e tjera, për shkak të situatave të tensionuara politike, forumet e hapura me kandidatët nuk u zhvilluan. Shumica e kandidatëve ishin të gatshëm për të biseduar rreth çështjeve të advokuara nga anëtarët e koalicionit dhe mbështetësit e tyre, por ata refuzuan të merrnin pjesë në forumet e hapura me praninë e kandidatëve të tjerë.

Në vend të forumeve, anëtarët e koalicionit organizuan takime individuale me të gjithë kandidatët, ku ata firmosën premtimet dhe u angazhuan për të punuar rreth plotësimit të çështjes nëse do të zgjidheshin në postin e kryetarit të bashkisë.

Në prag të ditës së votimit, koalicionet organizuan një konferencë shtypi në prani të mediave lokale, nëpërmjet të cilës informuan qytetarët mbi rezultatet e fushatës advokuese, si dhe në lidhje me firmosjen e premtimeve të bëra nga kandidatët.

3.5. Faza 5: Monitorimi i premtimeve zgjedhore

Në periudhën paszgjedhore, pas certifikimit të kryetarëve dhe këshillave bashkiakë nga KQZ, nisma vijoi me monitorimin e premtimeve të bëra. Partnerët Shqipëri organizoi workshope lokale në Korçë, Pogradec, Berat dhe Elbasan me anëtarët e koalicioneve për të hartuar një plan veprimi me aktivitete specifike për të monitoruar zhvillimet në lidhje me çështjet e tyre. Secili koalicion zhvilloi takime me kryetarët e zgjedhur për të sjellë në vëmendjen e tyre premtimet e bëra gjatë fushatës zgjedhore dhe për të siguruar edhe një herë angazhimin e tyre rreth çështjes.

4. REZULTATET KRYESORE TË FUSHATËS ADVOKUESE

Rezultatet dhe arritjet e **“Fuqizimi i Praktikave Demokratike të Pjesëmarrjes Aktive të Qytetarëve në Proceset Zgjedhore”** janë domethënëse falë punës së Koalicioneve Lokale si dhe metodologjisë së aplikuar gjatë procesit. Ndër rezultatet kryesore përmendim:

- ***Sjellja në vëmendje e shqetësimeve të qytetarëve.***

Fushatat advokuese treguan rëndësinë e fokusimit në çështje konkrete të komunitetit si një mjet për tejkalimin e mosbesimeve të lidhura me partitë. Duke e fokusuar vëmendjen në çështje dhe problematika konkrete, fushata e ndërmarrë nga secili koalicion lokal vërtetoi rëndësinë e pjesëmarrjes qytetare para, gjatë dhe pas zgjedhjeve. Përmes metodave të zbatuara, qytetarët përvetësuan njohuri dhe aftësi për teknikat lobuese dhe advokuese, si dhe ngritjen e partneriteteve dhe bashkëpunimeve që i ndihmuan ata gjatë fushatës së zhvilluar në qytetin e tyre. Gjithashtu, këto aftësi të fituara do t'i ndihmojnë ata në të ardhmen për të adresuar probleme dhe çështje komunitare.

- ***Rritja e pjesëmarrjes së organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve në procesin zgjedhor.***

Koalicionet lokale të përfshira në të katër qytetetet u angazhuan aktivisht në secilën fazë të fushatës advokuese për të përfshirë një numër sa më të gjerë mbështetësish. Sigurimi i mbështetjes u arrit falë procesit të informimit të qytetarëve dhe komuniteteve rreth iniciativës. Fushata ndërgjegjësuere advokuese e zhvilluar në çdo qytet arriti mijëra qytetarë, të cilët u informuan dhe u përfshinë në aktivitetet e fushatës.

- ***Forcimi i kapaciteteve lokale të organizatave të shoqërisë civile.***

Përfaqsj e zbatuar ndikoi në forcimin e kapaciteteve të grupeve të shoqërisë civile lokale. Programet e trajnimeve në advokasi dhe lobim, e teknika monitorimi, ndihmuan koalicionet lokale për të vendosur shqetësimet e qytetarëve në axhendën politike të kandidatëve. Forcimi i kapaciteteve lokale ndikoi në vendosjen e një komunikimi të drejtpërdrejtë midis kandidatëve për kryetar bashkie dhe qytetarëve.

- ***Bashkëpunimi ndërmjet aktorëve për zgjidhjen e çështjes prioritare.***

Bashkëpunimi ndërmjet të gjithë aktorëve lokalë për zgjidhjen e çështjes ishte i ngushtë. Përfaqsj e propozuar nga Partnerët Shqipëri (të punosh me kandidatët sesa të jesh kundër tyre) ndihmoi grupet advokuese në tërheqjen e vëmendjes së kandidatëve për kryetarë bashkie drejt çështjeve dhe problemeve prioritare në komunitetet e tyre.

5. MËSIMET E NXJERRA

Praktikat më të mira që rezultuan gjatë zbatimit të nismës së PSh, për të forcuar vlerat demokratike para dhe pas zgjedhjeve të 2011, janë fokusuar në një shumëllojshmëri aktiviteteve lokale. Kjo eksperiencë tregoi se vlerat dhe praktikat demokratike forcohen përmes:

- ***Përdorimit të zgjedhjeve për ngritjen e kapaciteteve advokuese.***

Zgjedhjet vendore shërbejnë si një moment i rëndësishëm për të fuqizuar kapacitetet lokale. Përpjekje të tilla theksuan edhe njëherë se qytetarët mund të mobilizohen dhe të mobilizojnë anëtarë të tjerë të komunitetit, të kultivojnë marrëdhënie, të mbledhin informacion, të identifikojnë burime, të zhvillojnë ndërgjegjësim publik në çështjet që ata i konsiderojnë si prioritare duke influencuar axhendën politike të kandidatëve për kryetar bashkie.

- ***Promovimit të aktivizmit jo-partiak mbi çështjet komunitare.***

Nisma e PSh konfirmoi rëndësinë e aktivizmit jo-partiak. Koalicionet lokale, të krijuara nga Partnerët Shqipëri, hartuan dhe zbatuan një plan advokimi duke u fokusuar në çështje konkrete komunitare, dhe jo në bindje politike dhe partiake. Si një grup jo-partiak koalicionet fituan besueshmërinë dhe legjitimitetin e komuniteteve me të cilët dhe për të cilët ata punuan.

- ***Përdorimit të mekanizmave demokratikë të pjesëmarrjes qytetare për të adresuar çështje lokale.***

Qytetarët mësuan të mobilizonin burimet për të ndërtuar marrëdhënie dhe inkurajuar veprime gjithëpërfshirëse dhe të bashkërenduara në emër të çështjes. Ajo çfarë u provua përmes nismës është se zgjedhjet mund të sigurojnë një mekanizëm, për të adresuar në mënyrë paqësore shqetësimet lokale.

- ***Organizimi i aktiviteteve publike në prani të mediave për të siguruar përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e kandidatëve ndaj qytetarëve.***

Përdorimi i medias si një komponent i rëndësishëm i përfaqësues së advokatisë bashkëpunuese që PA promovon, ndihmon në rritjen e përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë së kandidatëve ndaj premtimeve të bëra gjatë fushatës zgjedhore.

6. ANEKSE

6.1. Fushata Lokale Korçë

Qyteti i Korçës është një nga qytetet më të mëdha të Shqipërisë. Korça ka një popullsi prej rreth 86.000 banorësh nga të cilët 30% janë të rinj të moshës 15 – 25 vjeç. Korça është një qytet universitar me rreth 300 studentë dhe 1500 nxënës të shkollave të mesme që diplomohen çdo vit. Çështja më e dukshme dhe problematike për ta është punësimi dhe pjesëmarrja në jetën publike, sociale dhe kulturore. Ky fakt ndikon drejtpërdrejt në aspiratat dhe përgatitjet e tyre për të ardhmen dhe zhvillimin e komunitetit në një shoqëri demokratike.

Të rinjtë janë një komponent i rëndësishëm i zhvillimit shoqëror, një forcë drejtuese në reformat politike dhe ekonomike të vendit. Fatkeqësisht, në Korçë, institucionet e qytetit operojnë mbi bazën e programeve dhe shërbimeve të planifikuara çdo vit për të rinjtë, por ende ato nuk janë të bazuara në një strategji rinore të vërtetë dhe të strukturuar. Opinioni i të rinjve nuk dëgjohet dhe rekomandimet e tyre nuk merren në konsideratë. Mundësia për të angazhuar të rinjtë, përmes forcimit të roleve të tyre në jetën publike dhe qeverisje, tregon shkallën e demokracisë në institucionet dhe jetën publike në përgjithësi.

Duke marrë në konsideratë situatën, një grup OJF-sh rinore: Demokracia në Veprim – DIA, Klubi 21, Qendra “Aftësitë e Jetës” – SOL, Grupi Këshillimor i Komunitetit dhe Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (CSDC Korçë), si dhe studentë u bashkuan dhe formuan Koalicionin e Pjesëmarrjes së të Rinjve në Vendim-marrje. Koalicioni synoi të mbështesë të rinjtë dhe të adresojë çështjet shqetësuese të të rinjve dhe studentëve në qytetin e Korçës, të forcojë zërin rinor për të kërkuar qeverisje më të përgjegjshme dhe transparente, si dhe të rrisë pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje.

Pas diskutimeve, anëtarët e koalicionit konsideruan mungesën e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset vendimmarrëse si një faktor kryesor që ndikon tek problemet që shqetësojnë të rinjtë në qytetin e Korçës. Hartimi i Strategjisë Rinore u konsiderua si një mjet i fuqishëm që do të siguronte rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset vendimmarrëse në bashkinë e Korçës për t’u dhënë zgjidhje problemeve të tyre. Kështu, nisma advokuese e zhvilluar nën sloganin “Të rinjtë në vendimmarrje – më shumë mundësi, më shumë zgjidhje” u fokusua në hartimin e Strategjisë Lokale të Rinisë në qytetin e Korçës.



Si rezultat i përpjekjeve advokuese dhe lobuese gjatë fushatës zgjedhore, koalicioni me mbështetjen edhe të aktorëve të tjerë lokalë, arriti marrjen e premtimeve për hartimin, miratimin dhe zbatimin e Strategjisë Rinore në Korçë nga të dy kandidatët për kryetar në Bashkinë e Korçës, Z. Niko Peleshi dhe Z. Andrea Mano.

Premtimi nga Z. Niko Peleshi u formalizua në një takim publik, në praninë e 80 të rinjve dhe medias, në të cilin u firmos një marrëveshje bashkëpunimi midis tij dhe koalicionit për të mbështetur hartimin dhe zbatimin e Strategjisë Lokale të Rinisë në Korçë.

Pas çertifikimit nga KQZ-ja të Z. Niko Peleshi si kryetar i bashkisë së Korçës, koalicioni i dërgoi një letër zyrtare kryetarit për të sjellë në vëmendjen e tij

premtimin e bërë dhe siguroi edhe njëherë angazhimin e tij për çështjen. Një grup pune i përbërë nga anëtarë të koalicionit dhe specialistë të bashkisë, përgjegjës për çështjet rinore do të punojë për të përgatitur Strategjinë e Rinisë, e cila pasi të finalizohet do të miratohet nga kryetari i bashkisë dhe nga Këshilli Bashkiak.

Të rinjtë në vendim-marrje
më shumë mundësi, më shumë zgjidhje

Unë Mbështes Qeverisjen e Mirë

Partnerët Shqipëri
Centra për Nivëzimin dhe Mësuesin Kofshë

Koalicioni për Përmirësimin e të Rinjve në Vendimeve
Korçë

Gjatë muajve Tetor – Dhjetor 2011, anëtarët e koalicionit u mbështetën nga një ekspert i Partnerëve Shqipëri dhe hartuan draftin e parë të strategjisë, që do të diskutohet me përfaqësuesit e bashkisë për t'u finalizuar dhe më pas do të kalojë për miratim në Këshillin Bashkiak.


6.2. Fushata Lokale Pogradec

Qyteti i Pogradecit ka një popullsi prej 45.000 banorësh ku rreth gjysmën e tyre e përbëjnë gratë dhe vajzat. Krahas shumë problemeve që gratë dhe vajzat ndeshin, papunësia renditet si çështja më e dukshme dhe shqetësuese. Ky problem prek më së tepërmi gratë të cilat janë kryefamiljare. Ato duhet të përballojnë të vetme, pa asnjë mbështetje, jetën e tyre dhe të fëmijëve. Aktualisht në qytetin e Pogradecit jetojnë 108 gra kryefamiljare dhe të gjitha ato janë të afta dhe të gatshme për të punuar, por e kanë të vështirë të gjejnë një punë që mund t'u sigurojë të ardhura për të plotësuar nevojat dhe kërkesat jetesore të familjeve të tyre.



Pavarësisht përpjekjeve të bëra nga grupe të ndryshme interesi për të përmirësuar jetesën e këtyre grave dhe fëmijëve të tyre, mbetet ende shumë për t'u bërë për t'u siguruar atyre punë të qëndrueshme në përputhje me aftësitë dhe kualifikimet e tyre.

Duke marrë në konsideratë situatën, një grup OJF-sh në Pogradec, të cilat punojnë për çështje sociale dhe të grave, si: Shoqata e Grave Intelektuale të Pogradecit, Shoqata "Përtëritja", Organizata "Integrimi i Gruas" dhe organizata "Unë Gruaja", u bashkuan dhe formuan Koalicionin për Mbështetjen e Familjeve në Nevojë me synim mbështetjen e nënave kryefamiljare dhe adresimin e çështjes së punësimit të tyre për të përmirësuar jetesën e familjeve në nevojë në qytetin e Pogradecit.



Gjatë fushatës elektorale, koalicioni organizoi një seri takimesh dhe aktiviteteve publike nën sloganin “Mbështet një nënë kryefamiljare, ndihmo një familje!” Si rezultat i përpjekjeve advokuese dhe lobuese gjatë fushatës zgjedhore, koalicioni me mbështetjen e grupeve të tjera të interesit, arriti të marrë premtime për krijimin e mundësive të punësimit të nënave kryefamiljare, nga të dy kandidatët për kryetar bashkie në Pogradec, Z. Artan Shkëmbi dhe Z. Luan Topçiu. Premtimi u formalizua kur të dy kandidatët firmosën premtimin e tyre në takimet individuale të zhvilluara me anëtarët e koalicionit, ku ata u angazhuan në:

1. Dhënien prioritet të punësimit të grave kryefamiljare në ndërmarrjet e bashkisë, sidomos gjatë sezonit turistik kur rritet numri i punëtorëve sezonalë.
2. Rritjen e rolit të bashkisë si një ndërlidhës me sektorin privat dhe bizneset që operojnë në Pogradec, për të siguruar mundësi punësimi për gratë kryefamiljare në përputhje me nevojat e biznesit dhe kualifikimet e tyre.
3. Përfshirjen e grave kryefamiljare në trajnime dhe kurse kualifikimi për të përfituar aftësi në përputhje me nevojat e tregut të punës.

Pas çertifikimit nga KQZ-ja të Z. Artan Shkëmbi si kryetar i bashkisë Pogradec, disa anëtarë të koalicionit organizuan një takim me të për të sjellë edhe njëherë në vëmendjen e tij çështjen prioritare, dhe morën përsëri angazhimin e tij për adresimin e çështjes.

Nga takimi me kryetarin, anëtarët e Koalicionit u informuan se nga lista e 108 grave kryefamiljare, 27 prej tyre ishin punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme nga bashkia dhe nga bizneset private.

6.3. Fushata Lokale Berat

Berati është një nga qendrat më të vjetra dhe më piktoreske të Shqipërisë, i përfshirë në listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në korrik të 2008. I quajtur “Qyteti i një mbi një dritareve” është e dukshme pse ka këtë emër kur sheh lagjen e Mangalemit të ndërtuar në një kodër të pjerrët dhe dritaret duken sikur janë vendosur njëra mbi tjetrën kur shihen në distancë. Ka një numër të konsiderueshëm xhamish, si Xhamia Mbret (1512), Xhamia e Plumbit (1555) dhe Xhamia e Beqarëve (1827), kjo e fundit me piktura të mrekullueshme në muret e jashtme të saj. Në lagjen e Mangalemit është hoteli “Mangalem” i ndërtuar në një vilë të mahnitshme otomane, hoteli i parë i hapur pas rënies së komunizmit. Në një vilë tjetër otomane të shekullit XVIII është vendosur Muzeu Etnografik përgjatë rrugës së ngushtë me kalldrëm që të çon në drejtim të qytezës. Berati dominohet nga kalaja e tij impresionuese, kala e ndërtuar mbi themelet e lashta ilire, përgjatë një kreshte shkëmbore mbi qytet. Shumica e ndërtesave brenda kalasë janë ndërtuar gjatë shekullit të XIV dhe ruhen si monumente kulturore. Me kalimin e viteve shumë nga këto ndërtesa janë rrënuar dhe tani kanë mbetur vetëm disa prej tyre. Kisha më e madhe është Katedralja e Shën Marisë, e rindërtuar gjatë 1797 dhe është monumenti më përfaqësues i arkitekturës post Bizantine në Berat. Aty është ngritur Muzeu Kombëtar Onufri në nder të Onufrit, piktorit të famshëm shqiptar të shekullit të XVI, që përmban një koleksion të madh të afreskeve të bukura nga Onufri. Në anën e majtë, në lindje të Beratit ndodhet mali i Tomorrit, një destinacion i shkëlqyer për alpinizëm si në verë ashtu edhe në dimër. Për rëndësinë dhe bukurinë e tij, qeveria shqiptare e ka shpallur malin e Tomorrit një Park Kombëtar. Parku Kombëtar i Malit të Tomorrit mbulon një zonë prej 4.000 hektarësh. Si shtesë e këtij thesari të madh historik, kulturor dhe bukurisë së natyrës, është kanioni i lumit Osum në Berat. Kanioni është një nga tërheqjet natyrore më spektakolare të Shqipërisë. Mënyra më e mirë për të eksploruar është në pranverë, kur bora shkrin dhe shirat bëjnë të mundur lundrimin në gjithë gjatësinë e kanionit me kajake. Gjatë kësaj periudhe, një numër i madh ujëvarash i japin kanionit një bukuri magjepsëse.

Megjithë burimet natyrore, historike e kulturore të sipërpërmendura, pushteti vendor, biznesi, institucionet e artit dhe kulturës, dhe të gjithë qytetarët e Beratit, nuk i kanë shfrytëzuar këto burime sa duhet, në funksion të zhvillimit lokal të qëndrueshëm të qytetit dhe kthimit të tij në një destinacion kryesor turistik. Në dy vitet e fundit situata paraqitet disi e ndryshuar në lidhje me përmirësimin e kushteve për turizëm dhe rritjen e vëmendjes së të gjithë aktorëve ndaj tij, si dhe rritjen e numrit të turistëve, por duke konsideruar mundësitë e mëdha dhe zhvillimet e deritanishme, mbetet ende shumë për të bërë. Ky konstatim vjen nga banorë të qytetit, intelektualë dhe aktivistë të shoqërisë civile, të cilët me mbështetje dhe lehtësim të Partnerëve-Shqipëri, prej fundit të vitit 2010 u organizuan në Koalicionin për Zhvillimin e Turizmit, me qëllim vendosjen e turizmit si prioritet zhvillimor në strategjinë lokale të zhvillimit dhe mandatin e ardhshëm


qeverisës 2011-2014.

Koalicioni i përbërë nga disa përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, si: Qendra e Gruas, Kryqi i Kuq, Parlamenti Rinor, Qendra e Këshillimit, Qendra e Shëndetit Mendor, Organizata për Mbrojtjen e Mjedisit, Universiteti UFO, përfaqësues të shkollave të mesme si dhe intelektualë nga institucione publike, u angazhua të trajtojë dhe të adresojë çështje të turizmit në Berat, me qëllim zhvillimin e tij si mundësi kryesore për të garantuar zhvillim në terma afatgjatë dhe mirëqenie për qytetarët e Beratit.

Koalicioni organizoi një sërë aktivitete të sensibilizuese

me aktorë e grupe të ndryshme interesi të lidhur me çështje të zhvillimit të turizmit, si dhe takime në shtabet elektorale të kandidatëve për të diskutuar me ta në lidhje me nevojën për zhvillimin e turizmit dhe vendosjen e kësaj çështjeje si prioritet. Përmes deklaratave, kandidatët u shprehën se do të angazhoheshin maksimalisht në punën e tyre për zhvillimin e turizmit dhe si prioritet strategjik për zhvillimin e qytetit. Pas zgjedhjeve, koalicioni zhvilloi një takim me kryetarin e rizgjedhur të bashkisë Z. Fadil Nasufi, për të rikonfirmuar vullnetin e tij në lidhje me zhvillimin e turizmit përmes një qasjeje strategjike.

Një sërë zhvillimesh pozitive ndodhën pas këtaj, duke përmendur finalizimin e strategjisë së turizmit të iniciuar prej më shumë se një viti me pjesëmarrjen e disa aktorëve lokalë, mes të cilëve dhe disa prej antarëve të Koalicionit Për Zhvillimin e Turizmit, si dhe mbajtjen e një konference me operatorë turistikë shqipëtarë e të huaj, për promovimin e Beratit, vlerave të tij si dhe futjen në të gjitha guidat turistike të këtyre vlerave. Anëtarët e Koalicionit, mbeten të angazhuar të kontribuojnë me mbështetjen e tyre për zhvillimin e turizmit. Në planet e bashkisë për vitin e ardhshëm është edhe zgjerimi i zyrës së turizmit, një premtim i dhënë ndaj koalicionit, i cili do të vazhdojë monitorimin.



6.4. Fushata Lokale Elbasan


Elbasani është një qytet në qendër të Shqipërisë, pranë lumit Shkumbin në rajonin e Elbasanit. Është një nga qytetet më të mëdha në Shqipëri, me një popullsi prej 79,810 banorësh.

Zhvillimi industrial nisi njëqind vite më parë dhe arriti kulmin gjatë periudhës komuniste. Në ditët e sotme, zhvillimi industrial nuk është më një fushë kryesore që ndikon në zhvillimin e ekonomisë lokale. Gjithashtu Elbasani është një nga zonat më të mëdha agrikuturore në vend. Qyteti është i njohur për traditën e vjetër dhe të vyer në edukim dhe kulturë si dhe për burimet natyrore.

Pavarësisht kësaj, qyteti dhe zona në përgjithësi përballet me shumë probleme që lidhen kryesisht me zhvillimin ekonomik, ndotjen e mjedisit, dhe probleme sociale të grupeve të ndryshme të popullsisë.

Mungesa e një parku ose këndeve në lagje, ku fëmijët të mund të luajnë lirshëm gjatë ditës pa u kërcënuar nga rreziqet e aksidenteve, nga mjedise tejet të ndotura nga smogu i duhanit dhe gazrat e makinave, ishin disa nga çështjet që koalicioni “Ndihamoni fëmijët të jetojnë si fëmijë “ adresoi gjatë fushatës advokuese në Elbasan.

Koalicioni u përbë nga anëtarë të OJF-ve, si: shoqata “Tjetër Vizion”, “Forumi i Gruas Elbasan”, shoqata “Në Familje, Për Familjen”, “Terre des Hommes”, etj. Gjatë periudhës dhjetor 2010 – maj 2011 një seri aktivitetesh të gjera advokuese u organizuan nën sloganin “Më shumë hapësira për fëmijët tanë!”. Tryeza të rrumbullakëta dhe takime me përfaqësues të drejtorisë arsimore, organizatave



të shoqërisë civile, partive politike, aktorëve të fushës akademike, medias dhe biznesit u organizuan për të rritur ndërgjegjësimin publik të qytetarëve mbi çështjen dhe për të fituar mbështetjen e tyre. Pjesë e fushatës promovionale ishte dhe konferenca e hapur për shtyp e organizuar nga koalicioni me median dhe grupet e tjera të interes.

Si rezultat i takimeve me kandidatët për kryetar bashkie dhe stafet e tyre elektorale, u sigurua premtimi për të punuar rreth çështjes dhe për ta vendosur si prioritet në programin e mandatit të ardhshëm të qeverisjes lokale 2011-2014.

Koalicioni u takua me kryetarin e Bashkisë Z. Qazimi, pas rizgjedhjes së tij, për të diskutuar mbi mundësitë e krijimit të hapësirave për fëmijët dhe familjet e tyre. Duke marrë në konsideratë problemet me pronën private në disa zona, kryetari dhe ekspertët e bashkisë propozuan të krijonin çdo vit të mandatit të tyre, parqe në lagje të ndryshme, me gjelbërim dhe lehtësira argëtimi. Koalicioni zhvilloi takime me grupe qytetarësh për të rritur ndërgjegjësimin mbi procesin e buxhetimit me pjesëmarrje dhe dhënien e mbështetjes së tyre mbi çështjen si prioritet, kur stafi i bashkisë të organizojë procesin në çdo lagje. Koalicioni vazhdon përpjekjet monitoruese për çështjen.

MË SHUMË HAPËSIRA PËR FËMIJËT TANË!

Unë Mbështes Qeverisjen e Mirë

Partnerët-Shqiptari
Qendra për Ndryshim dhe Mirënjohje Korëkë

Koalicioni "Ndihmoni Fëmijët të jetojnë si të SM!

Elhasan

Mbledhjetë Strategjike nga Programi i Bashkëveprimësive dhe Komunitetit për Demokraci, Aftësi dhe SH.P.A.-je në Tiranë